



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR VLORË-HIMARË
SEKTORI I MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Nr. 2846 Prot.

Vlorë, më 13.12. 2022

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012. "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 100, datë 25.02.2022, "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar zhvillojnë procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe në zbatim të shkresës nr.5559 prot., datë 30.08.2022, "Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2022-2023", **ju njoftojmë se:**

Të gjithë praktikantët, të cilët kanë përfunduar praktikën profesionale në periudhën e parë mësimore **Shtator 2022-Dhjetor 2022**, janë të lutur të dorëzojnë pranë ZVAP Vlorë-Himarë portofolin e praktikantit, i cili duhet të përmbajë:

1. Planin lëndor vjetor
2. Planin e periudhave për lëndën përkatëse
3. Plane ditore të orëve mësimore (2-3 modele)
4. Teste të kapitujve ose të periudhës (2-3 modele)
5. Projektin kurrikular të nxënësit (1-2 modele)
6. 2-3 shembuj të përdorimit nga praktikanti të burimeve të mësimdhënies, përveç tekstit të nxënësit, veçanërisht të përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësit;
7. 3-4 shembuj të metodave që ka përdorur praktikanti, për të formuar të nxënësit aftësitë e :

- a) komunikimit me gojë dhe shkrim
- b) të menduarit kritik
- c) të menduarit krijues
- d) të punuarit në grup
- e) të gjithëpërfshirjes
- f) të menaxhimit nga nxënësit të informacionit mësimor nga burime të ndryshme
- g) të përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie
- h) të punës me nxënësit me vështirësi në të nxënë
- i) të punës me nxënësit me prirje të veçanta

8. Raportin e praktikantit me reflektime mbi përvojat e tij gjatë praktikës profesionale, me sukseset më të spikatura dhe vështirësitë kryesore, sipas shtojcës nr.6, “Raporti I praktikantit”, bashkëlidhur urdhërit nr.100, datë 25.02.2022, i ndryshuar.

Afati i dorëzimit të portofolit të praktikantit është nga data 16.12.2022-23.12.2022.

**DREJTOR
LEART SINAMATAJ**

